



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 04.11.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e protokollit nr. 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Anila Agalliu, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Tom Doshi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Katrin Treska – drejtoreshë e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Eljona Bylykbashi – përgjegjëse e Sektorit të Studimit të Analizës së Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot do të shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e protokollit nr. 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Kemi të ftuara nga Ministria e Drejtësisë zonjën Treska dhe zonjën Bylykbashi, si përherë në komisionin tonë.

Zonja Treska dhe zonja Bylykbashi, mund të bëni një përmbledhje të shkurtër, ju lutem?

Katrin Treska – Faleminderit, zoti kryetar!

Ratifikimi i protokollit nr. 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ka për qëllim zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare të Këshillit të Europës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, ky protokoll shërben edhe për mbështetje nga ana e autoriteteve shqiptare të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si edhe për lehtësimin e mundësisë së qytetarëve në ushtrimin e të drejtave dhe interesave të tyre në mënyrë sa më efektive. Në konferencat e zhvilluara Interlacken dhe Izmiri, përkatësisht në vitet 2010 dhe 2011, shtetet anëtare ranë dakord njëzëri se ishte i domosdoshëm reformimi i mekanizmit të supervizimit të Konventës, me qëllim për të siguruar efektivitetin e saj në terma afatgjatë. Ky protokoll është miratuar në parim me vendimin nr. 597, datë 17.01.2013 të Këshillit të Ministrave dhe është nënshkruar në Strasburg më 11 shkurt të 2014-s.

Protokolli nr. 15 shton në preambulën e Konventës një referencë të qartë për parimin e subsidiaritetit, si edhe doktrinën e lirisë së veprimit. Gjithashtu, protokollin sjell edhe ndryshime të tjera, duke përfshirë edhe shkurtimin e afatit, nga 6 në 4 muaj, brenda së cilit një aplikim mund të bëhet në gjykatë pas datës së vendimit përfundimtar të brendshëm. Kjo nënkupton se çdo person fizik, organizatë joqeveritare ose grup qytetarësh mund të paraqesin kërkesë pranë Gjykatës për të Drejtat e Njeriut në Strasburg me pohimin se u janë shkelur të drejtat e mohuara në Konventë dhe gjykata mund të procedojë kërkesën pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridikevendase në një afat prej 4 muajsh pas vendimit përfundimtar të brendshëm.

Protokolli është ratifikuar deri më tani nga 22 shtete anëtare, ndërkohë që 19 shtete kanë nënshkruar dhe prej tyre priten të ndiqen procedurat e brendshme të ratifikimit. Ky protokoll synon ta bëjë Gjykatën e Strasburgut më efektive duke vendosur në dispozicion të saj

mjete efikase për menaxhimin e ankesave të paraqitura në të, si dhe duke garantuar efikasitetin e së drejtës për dëshmipërbllim individual.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Treska!

Zonja Agalliu, si relatore, urdhëroni!

Anila Agalliu – Faleminderit, zonja Treska, për të gjitha detajet e projektligjit!

Komisioni për Çështjet Ligjore e shqyrton projektligjin “Për ratifikimin e protokollit nr. 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore” në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit. Ratifikimi i protokollit nr. 15, i cili amendon Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, propozohet në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si edhe për të konfirmuar se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mund të vazhdojë të luajë rolin e saj në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Europë.

Ratifikimi i protokollit nr. 15 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore do të thellojë bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Europës, si edhe palëve të tjera kontraktuese në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Njëkohësisht, do t’u shërbejë edhe qëllimeve të drejtësisë për gëzimin nga shtetasi për një mbrojtje më të mirë ligjore.

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Në momentin që do ta diskutojmë nen për nen, kam një rezervë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje? Nuk ka pyetje.

Ka diskutime? Nuk ka diskutime.

Jeni dakord në parim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Vazhdojmë me nenin 1.

Anila Agalliu – Zoti kryetar!

Fatmir Xhafaj – Po.

Anila Agalliu – Neni 1 i projektligjit të formulohet: “Ratifikohet protokolli nr. 15 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji”.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Po.

Faleminderit!

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Në tërësi kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, të gjithëve!

MBLEDHJA MBYLLET